



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT



10 Nr. 677 /2021

Datë: 23.08.2021

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 “Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës” dhe Kushtet dhe kriterët për regjistrim. Si dhe në pajtim me udhëzimet përkatëse të shpallura nga MASHT:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË VUSHTRRI SHPALL

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITI SHKOLLOR 2021/22 AFATI I GUSHTIT

Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për Gjimnazin në Vushtri:

SHKOLLA	Drejtimi	Nr. i Paraleleve	Nr. Nxënësve në një paralele	Gjithsej për drejtim
Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtri	Natyror	1	12	12
	Shoqëroro – Gjuhësor	2	29	58
Gjithsej:		3	41	70

Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për shkollën teknike- Vushtrri

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.	vende të li	Vit. e shkoll.		
Vushtrri	Sh.M.T. "Lutfi Musiqi"	Makineri	Operator i Trafikut Rrugor	1	24	10	2+1		
			Metalpunues	1	24	16	2+1		
			Operator Prodhimi	1	24	23	2+1		
			Perpunimi i Drurit	1	24	20	2+1		
			Automekanik	1	24	7	2+1		
	SH.M.T."L.Musiqi"	Elektroteknikë	Instalues Elektrik	1	24	7	2+1		
			Energjetikë	1	24	16	2+1		
			Mekatronikë	1	24	17	2+1		
			Teknik i Telekomunikacion	1	24	24	2+1		
			Teknik i sistemeve te TIK-ut,	1	24	4	2+1		
			Teknik i informatikes se Biznesit,	1	24	3	2+1		
			Teknik i Elektroteknikes	1	24	24	2+1		
			Gjithsej -"L.Musiqi-Vush."			10	240	171	

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente: - Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron) - Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe - Certifikatën e lindjes.

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2021/22, mund të konkurojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Konkursin dhe kriteret e detajuara për secilin drejtim i gjeni të publikuara në shkollat përkatëse dhe në web faqen e Komunës së Vushtrrisë; <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/>

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

-Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2021/2022, bëhet më datë : **23, 24, 25** gusht 2021 duke filluar nga ora 8:00-16:00.

-Shpallja e rezultateve më **26.08.2021**

-Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 27.08.2021 deri me 01.09.2021. duke filluar nga ora 8:00-16:00.

AFATI I ANKESAVE`

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejt, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës.

Vërejtje: Mos ankesa në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbje e të drejtës për ankesë në shkollën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). DKA dhe MASHT nuk shqyrton asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.